

## NJOFTIM PUNËSIMI

<b>Prezantimi i Shoqërisë Rajonale UK</b>	<p>Sh.a. Ujësjellës Kanalizime Rajoni Durrës është themeluar më 31.08.2022 sipas VKM nr. 302, dt. 11.05.2022 “Për Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”. Shoqëria Rajonale UK është një institucion profesional i licencuar për ofrimin e shërbimeve bazike të shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve. Ajo i shërben bashkisë Durrës, Shijak, Kavajë, Rrogozhinë dhe Krujë. Aktualisht Shoqëria Rajonale UK po kërkon të punësoj <u>për një vend pune: Faturues/e pranë Sektorit të Leximit në Njësinë Operative Kavajë</u> nisur nga data më e afërt. Punëmarrësi i ri do të jetë përgjegjës për leximin e rregullt (mujo) të matëseve të klientëve që ndodhen në zonën që mbulon. Detyrat përfshijnë gjithashtu kryerjen e verifikimeve në terren në funksion të kërkesave për lidhje të reja dhe/ose lidhje të kontratave të reja me qëllim parandalimin e abuzimeve dhe lidhjeve të dyfishta.</p>
<b>Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Gjatë leximit të matësit, kryen verifikime mbi gjendjen e matësit në lidhje me funksionimin e tij, vulosjen e tij, ndërhyrjeve të paligjshme dhe problematikave të tjera të ndryshme si rrjedhje, etj.</li><li>• Rezultatet e verifikimeve sipas rastit dhe procedurave të miratuara i regjistron dhe raporton si anomali si dhe mban përgjegjësi për mos-raportimin apo raportimin qëllimisht të gabuar të anomalive.</li><li>• Në fund të ditës dorëzon pranë Përgjegjës të Leximit, listat e plotësuara të leximit së bashku me regjistrin e anomalive (për zonat që nuk mbulohen me PDA).</li><li>• Siguron faturat nga Përgjegjësi i Leximit dhe vijon me shpërndarjen e faturave tek klientët që ndodhen në zonën që mbulon.</li><li>• Kryen verifikime të konsumit dhe matësit në terren sipas udhëzimeve të Zyrës së Faturimit në NjO dhe Drejtorisë së Shitjes në Drejtorinë e Përgjithshme.</li></ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Është i detyruar të vrojtojë, kontrollojë të gjithë përdoruesit e zonës së tij për të mos lejuar asnjë konsumator pa faturim si pasojë e mos-lidhjes së kontratës.</li> </ul>
<b>Kualifikimet e synuara dhe dokumentacioni:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Eksperienca pune të mëparshme.</li> <li>• Librezë e Punës</li> <li>• Certifikatë Familjare</li> <li>• Fotokopje e Kartës së Identitetit, Pasaportës</li> <li>• Dy fotografi</li> <li>• Fotokopje e Dëftesës me listën e notave e noterizuar</li> <li>• Dëshmi Penaliteti</li> <li>• Raporti Mjekësor</li> <li>• Vërtetim Vendbanimi</li> </ul>
<b>Kushtet e punës:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mundësinë për të punuar në një kompani të ngritur.</li> <li>• Mundësinë për të krijuar eksperiencë në kompani.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nëse jeni të interesuar dhe besoni se ju përmbushni të gjitha kërkesat për pozicionin e punës, ju lutemi aplikoni me letër përcjellëse, CV-në dhe dëshmi të kualifikimeve arsimore dhe profesionale (diplomë, certifikata, etj.) deri më datë 20.05.2026, pranë Protokollit të Dr.Përgjithshme Shoqërisë UK.Rajoni Durrës. Për çdo pyetje/paqartësi, ju lutemi kontaktoni në emailin zyrtar.</li> </ul>	